




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Të dhëna mbi veprimtarinë e SPAK në lidhje me subjektet e vetting-ut për vitin 2022

Procedime penale të regjistruara

SPAK ka regjistruar 3 procedime penale të subjekteve të vetting-ut të cilët janë shkarkuar apo kanë dhënë dorëheqjen gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



100%

Ngritja e akuzës në gjykatën kompetente

SPAK ka dërguar kërkesën për gjykim në gjykatën kompetente për të 3-ja rastet e regjistruara.

75%

Nga 3 çështje për të cilat SPAK ka depozituar kërkesë në gjykatën kompetente, 2 prej tyre janë ende duke u shqyrtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

25%

Ndërkohë njera nga çështjet për të cilin SPAK ka depozituar kërkesën për gjykim, çështja është ende nën gjykim në Gjykatën e Posaçme të Apelit.



Veprat penale për të cilat është kërkuar deklarimi fajtor nga SPAK

Veprat penale për të cilat SPAK ka kërkuar deklarimin fajtor të subjekteve ndër 3 raste për të cilat ka depozituar kërkesën për gjykim për vitin 2022, janë:

- Një herë për veprën penale të fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, **parashikuar në nenin 257/a/2 të Kodit Penal.**
- Dy herë për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, **parashikuar në nenin 319/ç të Kodit Penal.**

